



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 20.1.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe
Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Armend Zemaj, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Agim Ademaj, Melihate Termkolli dhe Doruntinë Maloku.

Munguan: Milena Miliqeviq dhe Jakup Krasniqi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj- OSBE; Basi Berisha – IAP; Labinot Llapashtica – BIRN; Edita Kusari – USAID/EROL; Rinor Beka – NDI; Shefki Kastrati – NDI; Baki Gimolli dhe Ardian Bajraktari– MD; Dibran Istrefi – Klan Kosova; Arta Avdiu – KTV; Driton Selmanaj – KDI; Arton Demhasaj – Çohu dhe Artan Canhasi – KDI.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26 dhe 29.12. 2014;
3. Njoftim i Komisionit lidhur me funksionimin e institucioneve të pavarura;
4. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;

5. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që në pikën të ndryshme, Komisioni të njoftohet për disa kërkesa që janë adresuar, si:

- Njoftim lidhur me planin e punës së Komisionit për vitin 2015;
- Diskutim lidhur me mbajtjen e një takimi të përbashkët me përfaqësuesit e Shoqërisë Civile;
- Shqyrtimi i kërkesës së Grupit për Studime Juridike dhe Politike;
- Shqyrtimi i kërkesës së Avokatit të Popullit;
- Shqyrtimi i kërkesës së kërkesës së organizatës “Çohu”.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26 dhe 29.12. 2014

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 26 dhe 29.12. 2014, pa vërejtje.

3. Njoftim i Komisionit lidhur me funksionimin e Institucioneve të Pavarura,

Kryetarja, në fjalën e saj paraqiti para anëtarëve një pasqyrë të funksionimit të institucioneve të pavarura që bien në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion. Me theks të veçantë, foli për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili që nga dt. 31 gusht, është jofunksional, pasi disa prej tyre iu ka skaduar mandati. Në vazhdim, i njoftoi me dosjen e Këshillit Gjyqësor ku janë propozuar disa emra të mundshëm për anëtar. Në shkresën përcjellëse Këshilli ka sqaruar se nuk është i autorizuar të propozojë emra, pasi që neni 108, paragrafi 6 i Kushtetutës, përcakton se 8 anëtarë zgjedhën nga Kuvendi, por nuk sqarohet se nga kush propozohen, zgjidhje nuk ofron as ligji. Në të kaluarën propozimet janë bërë nga grupet parlamentare, duke bërë pazare për caktimin e anëtarëve në një institucion që cilësohet si i pavarur, së paku në letër. Ajo paraqiti shqetësimin e saj edhe lidhur me propozimin e Odës së Avokatëve, e cila ka propozuar vetëm një anëtar. Aktualisht, Kuvendi duhet të plotësojë 5 pozita të lira, ku prej tyre 3 shqiptarë, siç përcaktohet në nenin 108, paragrafi. 6, pika 2 e Kushtetutës, 1 serb sipas nenit 108, paragrafi 6, pika 3 dhe një anëtar nga komuniteti tjetër, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, pika 4. Tani jemi në mes të disa dilemave, a t'i procedojmë këto propozime të Këshillit, edhe pse nuk kanë të drejtë apo të shkojmë me propozimet e grupeve parlamentare, e që personalisht jam kundër një praktike të tillë. Ishte e mendimit se zgjidhja më e mirë është të bëhet përzgjedhja përmes një konkursi publik.

Armend Zemaj, tha se ne duhet të veprojmë sipas Kushtetutës dhe ligjit, kurse lidhur me modalitetet sesi do të veprojmë, është çështje e Komisionit. Si Komision, duhet jemi të kujdesshëm, sepse kemi të bëjmë me një institucion të pavarur dhe të rëndësishëm për funksionimin e drejtësisë në vend. Ishe i mendimit se kjo çështje duhet trajtuar si e veçantë, në një mbledhje të veçantë, si pikë e vetme e rendit të ditës. Propozoi që kryetarja e Komisionit të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor që ta dërgojë listën complete të gjyqtarëve, po ashtu nga Oda e Avokatëve listën e avokatëve, dhe në bazë të kriterëve të caktuara, do ta procedojmë.

Selvije Halimi, tha se si shoqëri kemi evoluar dhe çdoherë e më shumë po vërejmë se në segmente të caktuara ka zbrazëtira ligjore, siç është tani rasti me Këshillin Gjyqësor. Sidoqoftë, ne si bartës të institucioneve duhet të kemi kujdes me rastin e vlerësimeve, përkundër asaj që si shoqëri jemi të pakënaqur me funksionimin e sektorit të drejtësisë, flas për gjykatat. Mirëpo, ne duhet të japim kontributin tonë, mos të japim vetëm kritika, në mënyrë që të përmirësojmë këtë institucion me përzgjedhjen e anëtarëve. Meqë nuk i kemi të specifikuar procedurat e përzgjedhjes, do të ishte mirë që kjo çështje të diskutohet në një mbledhje të veçantë, në mënyrë që të kemi kohë të analizojmë sesi do të procedojmë tutje.

Melihate Termkolli, tha se kjo është një çështje ndër më të rëndësishmet që ka ky Komision, jo vetëm si komision, por edhe Kuvendi, mbase edhe shoqëria e Kosovës. Kjo, sepse kemi të bëjmë me një institucion i cili aq shumë është kritikuar dhe aq shumë ka pasur probleme e që konsiderohet fusha më e parealizuar në Kosovë, pra fusha e drejtësisë. E kemi potencuar disa herë se shteti është uzurpuar nga politika dhe nëse vazhdohet me këto uzurpime të institucioneve nga politika, vendi nuk do të ecë përpara. Prandaj, është koha fundit që duhet të merret ndonjë veprim, i cili do të shënonte fillimet e rikthimit të gjyqësorit në funksionin e vet që ka dhe në funksionin e vet që duhet ta ushtrojë, e ajo është drejtësia. Është e vërtetë se brenda këtyre institucioneve janë krijuar grupe që nuk po lejojnë që të zhvillohen këtë institucione me njerëz profesionalë. Në vazhdim, tha se keni parë para disa herë që është dashur që gjyqësori të plotësohet me gjykatës dhe po këta njerëz që edhe vetë janë joprofesionalë, kanë konstatuar se të gjithë kandidatët për të hyrë në gjyqësor janë joprofesionalë, e kjo është e tmerrshme. Ishte e mendimit që kjo çështje duhet trajtohet si e veçantë në një mbledhje të veçantë, po ashtu të kërkohet nga Këshilli një raport të shkruar lidhur me procedurat e ndjekura për të propozuar anëtarët për emërim. Është e vërtetë se shumë institucione të pavarura, në letër, janë jofunksionale, për shkak të skadimit të mandatit të disa anëtarëve, por kjo nuk është arsye që të ngutemi dhe të bëjmë gabime. Ne duhet të ngutemi, por pa bërë gabime, të cilat kanë ndodhur deri më tani, që gjykatat të vendosin sipas kërkesave të politikanëve. Po ashtu, shprehu shqetësimin lidhur me mospërfshirjen e propozimeve nga Gjykata e Prishtinës, e që nuk figuron në dosjen e dërguar nga Këshilli Gjyqësor.

Pas diskutimeve, Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë

Përfundim

- I. Të caktohet një mbledhje e veçantë, me të vetmen pikë të rendit të ditës, ku do të diskutohet për zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së.
- II. Të ftohet kryesuesi i KGJK-së, z. Enver Peci dhe të kërkohet raport të shkruar lidhur me procedurat e ndjekura për të propozuar anëtarët për emërim nga Kuvendi.

4. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryetarja, tha se ky Projektligj ka qenë në procedurat e shqyrtimit edhe në mandatin e kaluar, por me shpërbërjen e Kuvendit, nuk ka arritur që të miratohet. Sa i përket përmbajtjes, konsideroi që ndryshimet janë shumë teknike, pasi që është e nevojshme që të ndryshohet në mënyrë përmbajtjesore, në mënyrë që të pamundësojë që zyrtarët e lartë të kenë 3 apo 4 vende pune. Vlerësoi se në parim i plotëson kushtet të procedohet, kurse për ndryshimet tjera do të vendoset në grupe punuese.

Agim Aliu, në fjalën e tij përsëriti kërkesën që Komisioni të punojë kolegjisht, siç jemi akorduar edhe në fillim, jo të japim nuanca politike. Sa i përket Projektligjit, tha se ndryshimet janë më shumë teknike, bile ky aspekt nuk është përmirësuar as në mënyrë gjuhësore, sintaksore dhe morfologjike. Ishte i mendimit që ta miratojmë në parim dhe në faza të mëtejme të formojmë edhe grupe punues që t'i japim përmbajtje. Ai tha se përveç efekteve pozitive që ka pasur Ligji për konfliktin e interesit, foli edhe për mangësitë e tij. Në këtë kontekst, përmendi anëtarët e kuvendeve komunale, të cilët janë të privuar nga të drejtat që i parasheh Ligji për konfliktin e interesit, duke i detyruar që të heqin dorë nga pozitat publike. Sikur edhe disa ligje tjera, edhe ky ligj në praktikë nuk është zbatuar në nivel të njëjtë në të gjitha komunat dhe fatkeqësisht ka shkaktuar diferenca me kategoritë tjera, siç janë shërbyesit civil.

Agim Ademaj, përmendi pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e hartimit të Projektligjit, derisa ka ardhur në Kuvend, duhet të ishte në nivel më të mirë dhe nëse kjo nuk është bërë, atëherë edhe ne duhet ta themi fjalën tonë në fazat tjera. U pajtua me parafolësin lidhur me kufizimet që parasheh Ligji për anëtarët e kuvendeve komunale, duke shtuar se kjo ndikon edhe në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, andaj duhet të kemi kujdes në fazat e amendamentimit.

Melihate Termkolli, u pajtua që projektligji mund të miratohet në parim, por në fazat tjera duhet të bëhen ndryshime esenciale, dhe mbi të gjitha, duhet të mbahet një dëgjim publik për këtë Projektligj me përfaqësuesit e institucioneve, shoqërisë civile dhe grupet tjera të interesit.

Pas diskutimeve, Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

5. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht

Kryetarja, tha se edhe ky Projektligj ka qenë në procedurat e shqyrtimit edhe në mandatin e kaluar, por me shpërbërjen e Kuvendit nuk ka arritur që të miratohet. Grupi i punës për këtë Projektligj ishte kryesuar nga deputeti Armed Zemaj dhe vlerësoi se mund të procedohet për miratim në parim, pastaj në faza tjera do të amendamentohet. Problem mbetet fakti që për implementimin e këtij ligji, nuk është paraparë buxhet e që shihet edhe nga deklaratat financiare e Ministrisë së Financave. E përkrah në parim, sepse është një avancim në aplikimin e masave alternative dhe në fazat tjera shohim se si do ta procedojmë me ndryshime.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht.

6. Të ndryshme

a. Njoftim lidhur me planin e punës së Komisionit për vitin 2015

Kryetarja, i njoftoi anëtarët se arsyeja pse nuk është shpërndarë draft-plani i punës së Komisionit për vitin 2015, është për faktin se ende nuk e kemi marrë Strategjinë legjislative të Qeverisë për t’i përfshirë në plan edhe projektligjet që do të procedohen në këtë Komision dhe afatet kohore.

b. Diskutim lidhur me mbajtjen e një takimi të përbashkët me përfaqësuesit e Shoqërisë Civile

Kryetarja, në vazhden e njoftimeve, propozoi që për të treguar një transparencë dhe një bashkëpunim me shoqërinë civile, Komisioni është mirë të mbajë një takim të përbashkët me përfaqësuesit e shoqërisë civile, për të parë modalitetet e bashkëpunimit në të ardhmen. Kjo vetëm sa për t’u dakorduar në parim, kurse për kohën e mbajtjes do të shohim se kur mund ta organizojmë.

Selville Halimi, u pajtua që të mbahet një takim i përbashkët, por kërkoi që paraprakisht të ketë një agjendë të qartë se cilat çështje do të jenë pjesë e diskutimeve.

Kryetarja, sqaroi se në përgjithësi do të tregojmë një transparencë me shoqërinë civile, kurse për modalitetet e bashkëpunimit do të shohim sesi do t’i përcaktojmë. Edhe përkundër asaj se ata njoftohen për secilën mbledhje të Komisionit, pjesëmarrja e tyre është e nevojshme në fazat e caktuara.

Melihate Termkolli, kërkoi nga parafolësi që mos të ngatërrohet nocioni mbikëqyrje dhe monitorim, sepse janë dy gjëra të ndryshme, ngase shoqëria civile nuk mbikëqyrë punën e Kuvendit, ajo monitoron. Mbikëqyrjen e bën Kuvendi në institucionet tjera, në veçanti ndaj ekzekutivit, kurse Kuvendin e mbikëqyrë vetëm Kushtetuta, ligji dhe qytetarët. Jam për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe nuk mund të them se ka munguar ky bashkëpunim ndonjëherë. Nuk besoj që ndokund në botë ka mundësi të ketë përfaqësues të shoqërisë civile sesa në Kuvendin e Kosovës. Askujt nuk i ndalohej që t'i përcjellë seancat apo komisionet parlamentare.

Agim Aliu, u pajtua se është i mirëseardhur një takim i përbashkët me shoqërinë civile, sepse puna jonë është transparente dhe ka nevojë që të monitorohet nga dikush. Gjithashtu, tha se është mirë që ta kemi një listë të atyre organizatave që kanë shprehur dëshirën që të takohen me ne, thjesht për njoftim.

Në fund të diskutimeve për këtë çështje, Komisioni u pajtua që të mbahet një takim i përbashkët me përfaqësuesit e shoqërisë civile.

c. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit për Studime Juridike dhe Politike

Kryetarja, tha se ka pranuar një kërkesë nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, për monitorimin dhe përmirësimin e Ligjit për financimin e partive politike. Në bazë të Rregullores së Punës, Komisioni për Buxhet dhe Financa, mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me financat publike, andaj Ligji për financimin e partive politike nuk bie në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion. Po ashtu, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 11 shkurt 2013, ka miratuar Strategjinë dhe planin e veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017, si dhe duke pasur parasysh faktin që monitorimi i këtij ligji ka dalë si sfidë nga Raporti i Progresit për Kosovën, do të ishte mirë që si komision, t'i rekomandojmë Komisionit për Buxhet dhe Financa, që në cilësi të Komisionit Funkcional, ta përfshijë në planin e punës për vitin 2015, mbikëqyrjen e Ligjit për financimin e partive politike.

Melihate Termkolli, tha se ne nuk mundemi si Komisioni, nuk mund t'i rekomandojmë një komisioni tjetër, se çka duhet të bëjë, por ne duhet që përgjigjja t'i kthehet adresuesit të kërkesës, duke i thënë se nuk jemi komision kompetent për këtë çështje, sepse e njëjta bie në fushëveprimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Meqë kishe mendime të ndara për adresimin e kësaj çështjeje, kryetarja e vuri në votim propozimin e deputetes Melihate Termkolli, i cili edhe u përkrah nga shumica e anëtarëve të Komisionit.

d. Shqyrtimi i kërkesës së Avokatit të Popullit

Kryetarja, i njoftoi anëtarët se ka pranuar një kërkesë nga Avokati i Popullit, për marrë nismën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese e që ka të bëjë vetëm me afatin kohor, ku Avokati i Popullit i drejtohet Gjykatës Kushtetuese e që është 6 muaj. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se ky afat duhet të ndryshohet, duke hequr kufizimet që parasheh për Avokatin e Popullit. Kjo vetëm sa për njoftim, pasi që nëse pajtoheni, ne mund ta përfshijmë si nismë të Komisionit në planin e punës, kur do të diskutohet në takimet e radhës.

i. Shqyrtimi i kërkesës së organizatës “Çohu”

Kryetarja, i njoftoi anëtarët se ka pranuar një kërkesë nga organizata “Çohu” pasi që Komisioni për Legjislacion mbikëqyrë punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit, është kërkuar që si Komision të kërkojmë nga Agjencia formularët e deklarimit të pasurisë për zyrtarët e kësaj Agjencie, përfshirë edhe drejtorin. Kjo ngase hetimi i pasurisë për zyrtarët e kësaj Agjencie nga vetë Agjencia, është konflikt interesi.

Selviqe Halimi, tha se kjo çështje bie në fushëveprimin e këtij Komisioni, por kërkoi që anëtarët e Komisionit çdoherë të kenë nga një kopje të këtyre kërkesave kur shqyrtohen në Komision. Ne sot nuk e kemi kërkesën e kësaj organizate. Meqë me Ligjin për deklarimin e pasurisë është e paraparë si datë e deklarimit 1-31 mars për deklarim, mbi këtë bazë edhe ne si komision ta përdorim me analogji që ta kërkojmë deklarimin e pasurisë për zyrtarët e Agjencisë.

Melihate Termkolli, nuk e kuptoj se si i bie kjo punë, Agjencia na kontrollon ne, kurse ne si Komision e kontrollojmë Agjencinë. Ishte e mendimit se për këtë çështje duhet të gjendet një modalitet i cili në mënyrë specifike e rregullon këtë çështje, sepse edhe nëse i marrim ata formularë, nuk e di çka do të themi, sepse nuk jam profesioniste për atë çështje, aq më tepër kur nuk i kemi formularët për vitet paraprake. Si mund të bëjmë krahasime?

Kryetarja, kërkoi nga parashtuesi i kërkesës që ta njoftojë dhe të arsyetojë kërkesën para Komisionit.

Arton Demhasaj, sqaroi se në Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit thuhet që të krijohet një komision në Kuvend për mbikëqyrjen e Agjencisë, e që ky Komision është kompetent edhe për mbikëqyrjen e deklaratave financiare të zyrtarëve të lartë të Agjencisë. Meqë Kuvendi nuk ka krijuar Komision tjetër, por këtë kompetencë ia ka dhënë Komisionit për Legjislacion, vlerësojmë se është krejt e qartë se ky Komision ka autoritet të kërkojë edhe deklaratat financiare që nuk guxojnë të publikohen në ueb-faqen e Agjencisë, pa e dhënë pajtimin Komisioni për Legjislacion. Kurse mënyra sesi ky Komision e bën këtë punë, edhe kjo është e rregulluar, sepse në këtë ligj thuhet se në Ligjin për deklarimin e pasurisë të gjitha afatet ligjore, të gjitha dispozitat që vlejnë për zyrtarët tjerë, vlejnë edhe për zyrtarët e Agjencisë. Pra, edhe zyrtarët e

lartë të Agjencisë, janë të obliguar që nga data 1-31 mars, formularët e deklarimit të pasurisë t'i dorëzojnë në Komisionin për Legjislacion, i cili i shikon, e që është kontroll paraprak dhe jep leje që ato të publikohen në ueb-faqen e Agjencisë. Kurse te kontrolli i plotë që është i paraparë me ligj që çdo vit bëhet, ka ra që në mesin e tyre të jetë edhe Hasan Preteni dhe ne vlerësojmë se edhe kjo çështje është e Komisionit.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që për këtë çështje të diskutohet edhe në një takim të radhës dhe kërkesa t'ju shpërndahet anëtarëve të Komisionit, paraprakisht.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
